



01 Nr. 044/26 Dt. 29.01.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643. të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit

1. Lejohet të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Vendimit nr. 01 nr. 191/25, i datës 17.03.2025, që ka të bëjë me formimin dhe emërimin e Komisionit për inspektimin e Ndërmarrjeve private "Kamila" dhe "Fatoni-1", ndërmarrje të cilat i shfrytëzojnë pronën publike komunale, kështu që, në vend të Shpresa Osmanollaj e emëruar si në pikën 1.2 të vendimit bazik emërohet Ylber Gashi nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe këtij Vendimi i shtohet edhe 1 (një) pikë si në vijim:
2. Mandati i komisionit si në pikën 1 të vendimit bazik i ndryshuar dhe plotësuar me këtë vendim do të jetë 4 vjeçar dhe se i njëjti duhet ti raportojë kryetarit 2 herë gjatë vitit kalendarik përkatësishtë çdo 6 muaj.
3. Pjesët tjera të Vendimit nr. 01 nr. 191/25, i datës 17.03.2025, mbesin të pandryshuara.
4. Obligohet Sektori i Pronës, Komisioni dhe të lartcekurit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Sektorit të Pronës,
 - Komisionit,
 - Të lartcekurve,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

